

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, PËR THEMELIMIN E QENDRAVE KULTURORE DHE INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE TË QENDRAVE KULTURORE DHE INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për themelimin e qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kjo marrëveshje është miratuar, në parim, me vendimin nr.127, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për themelimin e qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Maqedonisë së Veriut”. Pas miratimit në parim, marrëveshja është nënshkruar nga z. Gent Cakaj, në *Washington*, SHBA, në datën 3.4.2019, dhe është dërguar në Ministrinë e Kulturës e nënshkruar, nëpërmjet shkresës nr.7957, prot., datë 30.5.2019, nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Këto qendra, të cilat do të funksionojnë nën varësinë e misionit diplomatik të vendeve respektive, do të ndihmojnë në njohjen e kulturës shqiptare nga populli maqedonas dhe anasjelltas.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji është në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e qeverisë për të rritur dialogun kulturor, për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me shtete të ndryshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji ka në fokus zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e kulturës, përhapjen e kulturës shqiptare dhe prezantimin e saj në Maqedoninë e Veriut dhe anasjelltas. Kjo do të realizohet nëpërmjet ngritjes së qendrave kulturore dhe informative, të cilat do të prezantojnë kulturën e shteteve respektive nëpërmjet organizimit të eventeve, ekspozitave, ligjëratave letrare, promovimit në media dhe ofrimit të shërbimeve informative për qytetarët e interesuar të të dyja palëve. Hyrja në ambientet e qendrave kulturore dhe informative dhe në eventet e organizuara prej tyre do të jetë e lirë për qytetarët. Qendrat kulturore dhe informative janë qendra shtetërore dhe mënyra e financimit të tyre do të përcaktohet nga secila palë.

Qendrat do të ngrihen si pjesë e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë, e akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe anasjelltas. Secila nga qendrat do të drejtohet nga një drejtor, i cili emërohet nga qeveria e palës dërguese, ndërsa veprimtaritë e tyre do t'i kryejnë nën udhëheqjen e përgjithshme të kreut të misionit diplomatik të Palës dërguese që po e financon atë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për themelimin e qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Shqipërisë dhe qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Maqedonisë së Veriut” është në përputhje me nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe mbështetet në nenet 78, 83, pika 1 dhe 121, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTVENDIMIN)

Ky projektligj nuk parashikon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për themelimin e qendrave kulturore dhe informative në

Republikën e Shqipërisë dhe të qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, sipas tekstit të mëposhtëm:

Neni 1 parashikon thelbin e kësaj projekt marrëveshjeje, i cili është krijimi i qendrave kulturore dhe informative të Republikës së Shqipërisë dhe të qendrave kulturore dhe informative të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Puna e qendrave kulturore dhe informative zhvillohet në bazë të normave të së drejtës ndërkombëtare, neneve të kësaj marrëveshjeje dhe në pajtueshmëri me legjislacionin e vendit pritës ndërkohë që koha e ngritjes së qendrave përcaktohet në bazë të planifikimeve buxhetore të secilës palë.

Neni 2 parashikon mënyrën e funksionimit të këtyre qendrave. Qendrat do të ngrihen si pjesë e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë e akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe anasjelltas. Secila nga qendrat do të drejtohet nga një drejtor, i cili emërohet nga qeveria e palës dërguese, ndërsa veprimtaritë e tyre do t'i kryejnë nën udhëheqjen e përgjithshme të kreut të misionit diplomatik – konsullor të palës dërguese, që po e financon atë, në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.7168, datë 10.10.1987, “Për ratifikimin e konventës së Vjenës “Për marrëdhëniet diplomatike”.

Drejtorët e secilës prej qendrave kulturore dhe informative, të cilët nuk kanë shtetësinë e vendit pritës, do të jenë mbajtës të pasaportës diplomatike, përderisa personeli tjetër, i cili punon në qendrën kulturore dhe informative të secilës palë, të cilët nuk kanë shtetësinë e vendit pritës, do të jenë bartës të dokumenteve zyrtare të udhëtimit. Drejtori dhe stafi i qendrave kulturore të të dyja palëve do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet në përputhje me Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961 dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të palës pritëse.

Neni 3 parashikon rolin e secilës palë për të siguruar qasje të lirë në ambientet e qendrave kulturore dhe informative dhe në manifestimet e organizuara prej tyre. Emrat zyrtarë të qendrave kulturore dhe informative mund të publikohen në tabela, afishe, formularë, si dhe në korrespondencën, në materialin informativ dhe komunikues. Secila nga palët do të zbatojë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar funksionimin normal të qendrave kulturore dhe informative të palës tjetër, në përputhje me parashikimet e marrëveshjes.

Neni 4, i ndarë në dy pika, parashikon të gjithë aktivitetet që mund të kryejnë këto qendra kulturore dhe informative, si:

- a) Të organizojnë në mjediset e tyre një bibliotekë dhe një dhomë leximi;
- b) Të botojnë ose të importojnë publikime në lidhje me informacionin kulturor dhe shkencor nga vendi i tyre;
- c) Të shfaqin filma brenda dhe jashtë ambienteve të tyre, me ndërmjetësimin e institucioneve kompetente përkatëse në vendin pritës;

- ç) Të organizojnë në mjediset e tyre ligjërata letrare, shkencore dhe të tjera, të shoqëruara, sipas nevojës, me ilustrime vizuale ose shfaqje muzikore;
- d) Të organizojnë në mjediset e tyre ekspozita të fotografive, vizatimeve, afisheve, librave, veprave origjinale ose riprodhimeve të artit;
- dh) Të ofrojnë shërbime informative për qytetarët e interesuar të të dyja palëve, si dhe për qytetarët e vendeve të treta;
- e) Të publikojnë dhe shpërndajnë buletine informative për ngjarjet dhe manifestimet e organizuara nga qendrat kulturore dhe informative, si dhe për punën e qendrave. Informimi përfshin përdorimin e teknologjive bashkëkohore të komunikimit;
- ë) Të mbështesin shkëmbimin e programeve televizive dhe të radios në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit tashmë të përfunduara ndërmjet institucioneve informuese të Palëve,

Ky nen parashikon, gjithashtu, se qendrat kulturore dhe informative do të shpërndajnë falas te publiku informacionin për itinerarin e aktiviteteve të renditura, që do të organizohen në secilën qendër.

Neni 5 parashikon që në kryerjen e veprimtarive të tyre, sipas kushteve të rëna dakord në marrëveshje, qendrat kulturore dhe informative do të veprojnë në përputhje me ligjet në fuqi të shtetit, në territorin e të cilit ato janë të vendosura.

Në nenin 6 parashikohet se qendrat kulturore dhe informative janë qendra shtetërore dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohet nga secila palë kontraktuese. Qendrat kulturore dhe informative kanë të drejtën të nënshkruajnë në vendin pritës marrëveshjeve të nevojshme për funksionimin e tyre. Për të mbuluar pjesërisht shpenzimet e tyre, qendrat kulturore dhe informative, gjithashtu, mund të sigurojnë të ardhurat e tyre nga shfaqet ose ngjarje të tjera kulturore.

Eksponatet e ekspozitave të organizuara nga qendrat kulturore dhe informative në mjediset e tyre ose në salla të tjera, si dhe objektet e karakterit artistik, si libra, CD, kaseta video dhe audio, mund të ofrohen për shitje vetëm me kusht nëse janë paguar detyrimet doganore, të mbledhura nga autoritetet doganore dhe të parashikuara në legjislacionin në fuqi të vendit pritës.

Në nenin 7 parashikohet se palët ofrojnë ndihmë në bazë të reciprocitetit për gjetjen e një mjedisi, ndërtese ose trualli të përshtatshëm për veprimtarinë e qendrave kulturore dhe informative. Kushtet për marrjen me qira ose blerjen e një mjedisi, ndërtese apo trualli të tillë përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi të palës pritëse.

Qendrat kulturore dhe informative mund të pajisen me mjete të përshtatshme audio-vizuale, informative, telekomunikuese dhe mjete të tjera të nevojshme për realizimin e aktiviteteve të tyre në përputhje me këtë marrëveshje.

Palët, në bazë të reciprocitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të palëve, do të lirojnë qendrat kulturore dhe informative nga pagesa e detyrimeve doganore, të taksave për kushtet e magazinës dhe kushtet e një natyre të ngjashme, në përputhje dhe në masën që përcaktohet në dispozitat e Konventës së Vjenës për mallrat të importuara që nuk janë për shitje, si më poshtë vijon:

- a) katalogët, afishet, njoftimet, programet, librat, imazhet dhe materialet audio-vizuale, të nevojshme për funksionimin normal të qendrave kulturore dhe informative;
- b) mallrat për import të përkohshëm: pajisjet teknike, mobiliet dhe materiali, duke përfshirë mjetet e trafikut të nevojshme për funksionimin e qendrave kulturore dhe informative;
- c) filmat, të projektuar në ambientet e qendrave kulturore dhe informative ose jashtë tyre, në kuadër të ngjarjeve të organizuara nga qendrat kulturore dhe informative;
- ç) çdo lloj tjetër materiali me natyrë kulturore dhe informuese, i nevojshëm për funksionimin e qendrave kulturore dhe informative.

Bëjnë përjashtim nga parashikimi këtij neni, taksat për formalitetet doganore të kryera jashtë institucioneve të parashikuara për këtë qëllim ose jashtë orarit të punës të autoriteteve doganore.

Në nenin 8 parashikohet se tatimi mbi të ardhurat e qendrave kulturore dhe informative është në përputhje me legjislacionin tatimor të vendit pritës, si dhe në përputhje me marrëveshjet ekzistuese dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në nenin 9 parashikohen se palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për plotësimin e përbërjes së personelit në qendrat kulturore dhe informative, si dhe emërimin dhe shkarkimin e personelit të tyre. Personat që përbëjnë personelin e qendrave kulturore dhe informative dhe anëtarët e familjeve të tyre, që janë shtetas të vendit dërgues dhe që nuk kanë qëndrim të përhershëm në shtetin pritës, bien nën legjislaturën e marrëdhënieve të punës dhe sigurimit social të shtetit dërgues.

Qendrat kulturore dhe informative kanë të drejtë të punësojnë qytetarë nga vendi pritës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për marrëdhënie pune të vendit pritës.

Në nenin 10 parashikohen se secila nga palët, në bazë të reciprocitetit, do t'u japë personave nga stafi i qendrave kulturore informative të palës tjetër dhe bashkëshortëve e fëmijëve që jetojnë me ta, të gjitha lehtësimet, në përputhje me legjislacionin aktual për lëshimin në kohë të vizave dhe lejeve të qëndrimit në vendin pritës.

Lehtësime të ngjashme u jepen, gjithashtu, pjesëmarrësve në ngjarjet kulturore brenda programeve të punës së qendrave kulturore dhe informative.

Në nenin 11 parashikohet se çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin edhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve midis palëve.

Në nenin 12 parashikohen dispozitat e fundit të kësaj marrëveshjeje, ku theksohet se kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin njoftohet për kryerjen e procedurave të brendshme juridike të nevojshme për hyrje në fuqi të marrëveshjes në fjalë.

Marrëveshja është lidhur për një periudhë prej pesë vjetësh. Vlefshmëria e saj zgjatet automatikisht, për çdo periudhë pasuese prej pesë vjetësh, deri sa njëra prej palëve të mos e njoftojë me shkrim palën tjetër, së paku gjashtë muaj përpara mbarimit të afatit përkatës, me qëllim për të ndërprerë vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet me pajtueshmëri të ndërsjellë të palëve.

Në fund është përcaktuar se marrëveshja hartohet në gjuhën angleze, shqipe dhe maqedonase, nga ku teksti në gjuhën angleze merr përparësi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji janë Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Kulturës.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Kulturës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj shoqërohet me efekte financiare, të cilat konsistojnë në përjashtimin nga taksat e importit/detyrimet doganore për artikuj si mobiljet, pajisjet e zyrës, filmat, albumet me foto, posterat, librat, disqet, regjistrimet, mjetet edukuese dhe format e ndryshme të produkteve audio-vizuale të nevojshme për organizimin e aktiviteteve nga qendra e palës maqedonase, me

kusht që ato të mos përdoren për shitje apo përfitime të tjera në Shqipëri. Kosto, do të ketë, gjithashtu, edhe ngritja e qendrave kulturore dhe informative shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në pikën 3, të nenit 1, të marrëveshjes, përlogaritja e kostove për ngritjen e qendrës kulturore shqiptare do të realizohet në momentin në të cilin do të merret vendimi për ngritjen e kësaj të fundit në Maqedoninë e Veriut, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

KËSHILLI I MINISTRAVE